



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 25.9.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROGRAMIT,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT DHE KFW FRANKFURT AM MAIN,
PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “FONDI I INVESTIMEVE
SOCIALE IV”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 25 shtator 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KFW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”. Komisioni caktoi si relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, si dhe në nenet 17 dhe 23 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i Investimeve Sociale IV”.

Ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe programit për financimin e projektit “Fondi i investimeve sociale IV” konsiston në ndryshimin e nenit 3.2 të marrëveshjes, në të cilin përcaktohet afati i fundit i disbursimit të fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje, duke e shtyrë atë deri me datë 30 tetor 2018, si dhe në zëvendësimin e emërimit “Ministria e Financave”, kudo në tekst, me “Ministra e Financave dhe Ekonomisë”.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Elena XHINA

KRYETARI

Ulsi MANJA